

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Mitrovica – Raporti komunal

Tetor 2009

## Mitrovica në shifra

<b>Popullsia</b>	Gjithsej	<b>98,384</b>
	Shqiptarë	<b>93%</b>
	Serbë	<b>5%</b>
	Të tjerë	<b>2%</b>
<b>Gjeografia</b>	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	<b>350 km/2</b>
	Numri i fshatrave	<b>49</b>
<b>Shkollimi</b>	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	<b>10%</b>
	Fillore/e mesme e papërfunduar	<b>26%</b>
	E mesme	<b>49%</b>
	Shkollë e lartë	<b>12%</b>
	Universitet	<b>3%</b>
	Nr. i nxënësve	<b>19,408</b>
	Nr. i mësimdhënësve	<b>996</b>
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	<b>5</b>
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	<b>37</b>
	Nr. i çerdheve	<b>1</b>
<b>Shëndetësia</b>	Spital	<b>1 (në pjesën veriore)</b>
	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	<b>1</b>
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	<b>22</b>
	Nr. i mjekëve	<b>45</b>
<b>Papunësia</b>	Gjithsej	<b>52%</b>
	Meshkuj	<b>51%</b>
	Femra	<b>52%</b>
<b>Të punësuar</b>	Gjithsej fuqia punëtore (15-64 vjeç)	<b>60,014</b>
	Sektori publik	<b>2,399</b>
<b>Buxheti (2009)</b>	Gjithsej (Euro)	<b>11,524,978</b>
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	<b>1,326,300</b>
	Të hyrat tjera (Euro)	<b>10,198,678</b>
<b>Shpenzimet (2008)</b>	Gjithsej (Euro)	<b>10,959,274 (92%)</b>
	Shpenzimet kapitale (Euro)	<b>2,777,067 (80%)</b>
	Shpenzimet tjera (Euro)	<b>8,182,207 (96%)</b>
<b>Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007</b>	PDK	<b>36%</b>
	LDK	<b>21%</b>
	AAK	<b>5%</b>
	AKR	<b>21%</b>
	LDD	<b>8%</b>
	ORA	<b>5%</b>
	Tjera	<b>4%</b>
<b>Kryetarët e Komunës (1999-2009)</b>	2000-2002: Faruk Spahija (LDK) 2002-2007: Faruk Spahija (LDK), Mursel Ibrahimimi (LDK) 2007-2009: Bajram Rexhepi (PDK)	

## Shkurt për Mitrovicën

Mitrovica, dikur e Titos, pastaj “Kosovska”, ndërsa sot e veriut dhe e jugut, e ndarë në mes të shqiptarëve (në jug) dhe serbëve (në veri), të cilët nuk mund të gjejnë gjuhë të përbashkët për bashkëjetesë në këtë qytet. Që nga viti 1999, kur përfundoi lufta e fundit në Kosovë, Mitrovica ende mbetet shembull i keq dhe vatër e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve ndër-etnike. Territori i Mitrovicës, i pasur me argjend, plumb e metale të tjera të çmueshme, dikur njihej si zonë industriale që krijonte të hyra jo vetëm për Kosovën por edhe për ish-federatën e Jugosllavisë, ndërsa sot Mitrovica është një ndër qytetet me papunësinë më të madhe në Kosovë. Për shkak të mungesës së zhvillimit ekonomik dhe mungesës së vizionit për zhvillimin industrial të këtij qyteti, shumica e pasurive të Mitrovicës kanë mbetur të pashfrytëzuara për një kohë mjaft të gjatë, duke ndikuar kështu edhe në zhvillimin e përgjithshëm dhe mirëqenien e kësaj komune.

## Problemet aktuale

E tërë Kosova padyshim që ballafaqohet me problemin e papunësisë. Të gjitha hulumtimet e opinionit publik qartë e potencojnë këtë që nga koha kur statusi politik i Kosovës nuk është më problem kryesor. Duke qenë se Mitrovica është një ndër qytetet me papunësinë më të madhe në Kosovë, nuk është për çudi që edhe qytetarët e komunës së Mitrovicës brengosen kryesisht për problemin e punësimit. Megjithatë, e vlen të theksohet se papunësia është shumë e lartë në mesin e popullatës shqiptare sesa në mesin e popullatës serbe të kësaj komune.

Përtej problemit të papunësisë dhe problemit politik të ndarjes së qytetit në dysh, problemet tjera të përditshme me të cilat ballafaqohen qytetarët e Mitrovicës janë:

- Rrjeti i ujësjellësit,
- Ambienti i ndotur,
- Trafiku dhe ndërtimet pa leje,
- Shëndetësia,
- Siguria,

**Ujësjellësi.** Edhe pse Komuna e Mitrovicës ka burime të mjaftueshme të ujit të pijes, në këtë komunë uji i pijes është problem për shkak se nuk ka rrjet të mjaftueshëm të ujësjellësit dhe në ato pjesë ku ka ujësjellës ka reduktime të mëdha të ujit. Nga Komuna e Mitrovicës furnizohen me ujë edhe Komuna e Vushtrrisë dhe ajo e Skenderajt. Gjendja me furnizim me ujë në këto dy komuna është edhe më e rëndë se në Mitrovicë. Pjesa dërmuese e fshatrave të komunës së Mitrovicës kanë probleme me ujë të pijes, sidomos fshatrat e rajonit të Shalës dhe pjesa e epërme e qytetit – Bajra. Gjatë dy viteve të fundit ka pasur disa investime në rrjetin e ujësjellësit, si në fshatrat Koshtovë, Mazhiq, Brononiq, etj., por këto investime edhe pse të domosdoshme, nuk e kanë zgjidhur problemin me ujin e pijes edhe për një pjesë të madhe të fshatrave. Tentativa për të shtrirë ujësjellësit në fshatin Suhodoll ka ngjallur reagime të shumta tek serbët, me ç’rast KFOR-i ka ndërprerë punimet për “shkaqe sigurie”. Një problem i tillë ka ndodhur edhe me tri fshatrat veriore Vinarc, Gushavc dhe Vidimriq. Qyteti i Mitrovicës zakonisht ka reduktime të ujitë në mes orës 22.00 – 7.00, ose ndodh që të mos ketë ujë për një ditë të tërë. Përpos mungesës së rrjetit të ujësjellësit Komuna e Mitrovicës ka edhe reduktime konstante të energjisë elektrike (3 orë me dhe 3 orë pa energji elektrike). Problemet e ujit dhe të energjisë elektrike

vijnë si pasojë e ndarjes së burimeve me pjesën veriore, të cilët nuk paguajnë shpenzimet e tyre.

**Ambienti.** Për banorët e komunës së Mitrovicës është shumë shqetësuese papastërtia e ambientit që i rrethon. Mbi 48 kanalizime derdhen në Lumin Ibër, e duke marrë parasysh se lumi Ibër kalon përgjatë qytetit të Mitrovicës. Mbetjet industriale është një tjetër problem i komunës së Mitrovicës, e sidomos ato të Trepçës. Tek Sitnica (pranë tunelit) ka disa hektarë tokë me mbetje industriale. Deponia te Kelmendi gjithashtu është një tjetër zonë me mbetje industriale, prej së cilës nëpërmjet erës përhapen grimcat e ndryshme të këtyre mbetjeve të cilat i pengojnë banorët në frymëmarrje dhe janë kërcënim për shëndetin e tyre. Sipas një hulumtimi të OBSH-së për komunë e Mitrovicës thuhet se banorët e kësaj ane tejkalojnë sasinë e hekurit në gjak, e cila vie si pasojë e thithjes se ajrit me grimcat e hekurit që barten pikërisht nga këto zona me mbetje industriale.

**Trafiku dhe hapësirat publike.** Qytetarët kanë problem me trafikun urban në Mitrovicë. Trafiku rrugor i kësaj komunë është i ngarkuar me automjete, rrugë të ngushta dhe hapësira të pakta për parkim. Automjetet parkohen në vende të cilat janë të destinuara për lëvizjen e këmbësorëve duke penguar lëvizjen e lirë të qytetarëve. Pjesë të rrugëve të qytetit janë të mbushura me lloç, çka shkakton edhe më shumë problem për qytetarët. Edhe ndërtime të egra dhe shumëkatshe janë bërë shqetësim për banorët. Punimet në këto objekte zakonisht ndodhin pa masa mbrojtëse dhe qytetarët rrezikohen gjatë lëvizjes nën to. Ndërtesat e reja shumëkatshe nuk kanë lënë vend për parkim të automjeteve për banorët që janë vendosur në to. Rëndimin e gjendjes në komunikacion dhe në strukturën e qytetit e kanë shkaktuar edhe familjet e zhvendosura nga veriu i qytetit. Menjëherë pas luftës, në qershor 1999, shumë familje u detyruan që të lëshojnë shtëpitë e tyre nga pjesa veriore e qytetit. Sipas të dhënave të KMDLNI, gjatë këtyre viteve 1,540 familje janë larguar me dhunë nga kjo pjesë e qytetit. Si pasojë, këto familje kanë qëndruar në pjesën jugore tek të afërmit apo në banesa dhe shtëpi me qira. Në fillim të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka ndarë 360,000 euro për pagesën e qirasë për një vit për 360 familje të zhvendosura. Menaxhimi me mjetet dhe përzgjedhja e përfituesve iu la në dorë Komunës së Mitrovicës. Komuna pas dy muajsh të marrjes së këtij vendimi ka shpallë konkurs për përzgjedhjen e 360 familjeve përfituese të cilave do tu ndahen nga 100 € në muaj për pagesën e qirasë në vitin 2009. Konkursi ka mbete i hapur për një kohë të gjatë dhe për shkak se afro 500 familje kanë konkurruar për përfitim të mjeteve për qira, Komuna ka ndërruar kushtet e konkursit dhe vendimin e Qeverisë dhe ka vendosur që të rris numrin e përfituesve dhe të zvogëloj shumë më tej jepen atyre për qira. Shumë familje janë ndarë të pakënaqura me procedurën për përzgjedhjen e përfituesve dhe shumë të tjera nuk kanë qenë në dijeni të kësaj shpalljeje nga komuna.

**Shëndetësia.** Në komunën e Mitrovicës problem shumë evident është mungesa e spitalit (e cila ka mbetur në pjesën e veriut dhe udhëhiqet nga serbët). QKMF-ja është improvizuar dhe luan rolin e spitalit, sidoqoftë ka shumë mungesë të mjeteve të nevojshme, e gjithashtu edhe të stafit mjekësor. Shumë mjek janë larguar nga Komuna Mitrovicës dhe janë punësuar në Vushtrri, Prishtinë, apo edhe kanë hapur ordinancat e tyre private. Sipas qytetarëve ka shumë teknik por ka mungesë të specialistëve, prandaj në raste më të rënda duhet të udhëtohet për në Vushtrri apo Prishtinë. Duke marrë parasysh se qyteti i Mitrovicës është qendër industriale me shumë mbeturina industriale për të cilat nuk është gjetur asnjë zgjedhje, e gjithashtu

edhe kanalizimet që derdhen në lumin Ibër i cili kalon përgjatë qytetit – qytetarët e komunës së Mitrovicës shumë shpesh përballesh me sëmundje që duhet të trajtohen në Vushtrri apo Prishtinë. Vizitat jashtë Mitrovicës bartin edhe shpenzimet shtesë për udhëtim.

**Siguria.** Që nga pas lufta, përveç largimit të 1,540 familjeve nga veriu i Mitrovicës, gjatë tërë kohës kanë ndodhur edhe incidente ndëretnike, të cilat kanë marrë edhe jetë njerëzish. Vetëm gjatë vitit 2009, ka pasur dy incidente të rënda afër urës së Ibrit, me që rast janë lënduar qytetarë, dhe janë dëmtuar objektet dhe bizneset e qytetarëve. Banorët e Kroit të Vitaku janë penguar për gjashtë muaj radhazi dhe ende pengohen në punën e tyre për rindërtimin e shtëpive në këtë pjesë. Qytetarëve u ka humbur shpresa se diçka më mirë do të ndodhë sigurinë e tyre dhe pronat e tyre në veri. Kryetarin aktual të kësaj komune, Bajram Rexhepin, qytetarët e komunës e kanë parë si mundësi për relaksim dhe konflikteve ndëretnike, kthimin e interesimit të bashkësisë ndërkombëtare në zgjidhjen e problemit, etj., mirëpo një gjë e tillë nuk është arritur. Bashkimi i qytetit në bazë të dokumentit të Pakos së Ahtisaarit nuk ka filluar që të ndodhë deri më tani.

## Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në zgjedhjet e nëntorit 2007, kandidati i PDK-së ish-kryeministri Bajram Rexhepi fitoi të drejtën për ta udhëhequr komunën e Mitrovicës në dy vitet në vazhdim. Në raundin e parë **Bajram Rexhepi** fitoi **8,599 vota** apo **36.5%**, kurse në raundin e dytë ai fitoi **8,108 vota** apo **55.9%**. Bajram Rexhepi ka udhëhequr me Komunën e Mitrovicës edhe në qeverisjen e përkohshme nga qershori 1999 e deri në zgjedhjet e nëntorit 2000. Përveç që Bajram Rexhepi është kryetar i Komunës së Mitrovicës, ai është edhe kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Që nga viti 2007, vetëm dy nga pesë premtimet kryesore të kryetarit aktual të Mitrovicës, Bajram Rexhepit, janë realizuar deri më tani, dhe atë jo në tërësi. Premtimi për kompensimin e qirave ka filluar së realizuari, përderisa premtimi për vizitat nëpër varrezat e të afërmeve të tyre është realizuar vetëm për serbët (vizita në varrezat në jug), por jo edhe për shqiptarët (vizita në varrezat në veri).

Për më tepër, njëri nga premtimet e kryetarit të Mitrovicës, që ka të bëjë me integrimin e qytetit, i tejkalon kompetencat e nivelit lokal dhe në këtë mënyrë nuk i lë shumë mundësi kryetarit të komunës të angazhohet në këtë drejtim.

Gjithashtu, duhet të theksohet se shumica e premtimeve të kryetarit të komunës së Mitrovicës në fakt janë të ndërlidhura me problemet kryesore me të cilat ballafaqohet kjo komunë.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Integrimi i qytetit ashtu siç parashihet në Pakon e Ahtisaarit.	Integrimi i qytetit në bazë të Pakos së Ahtisaarit është problematikë që i kalon kompetencat e kryetarit të komunës. Deri më tani nuk është bërë asgjë konkrete në këtë drejtim, pra krijimi i një bordi të

	<p>përbashkët për Mitrovicën e jugut dhe Mitrovicën e veriut, mirëpo kryetari në çdo takim të tij me përfaqësuesit e lartë vendore dhe ndërkombëtarë e ka diskutuar nevojën që sa më shpejtë të zbatohet Plani i Ahtisaarit që ka të bëjë me krijimin e bordit të përbashkët për të dy “Mitrovicat”.</p>
<p>Bashkëpunimi me komunën e Vushtrrisë dhe atë të Skenderajt për të përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm</p>	<p>Deri më tani nuk ekziston një bashkëveprim i tillë mes komunave. Nga Mitrovica furnizohet me ujë edhe Vushtrria por edhe pjesa veriore e qytetit, dhe kjo ndikon që përkundër sasisë së mjaftueshme me ujë që ka Mitrovica, përsëri aplikohen reduktime të ujit. Ka pasur iniciativa për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit edhe në fshatra, dhe lista e investimeve kapitale e komunës shënon pesë projekte të ndryshme nëpër fshatra për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit, si në fshatin Broboniq, Mazhiq, Koshtove, në qytet, etj. Mirëpo jo gjithnjë shtrirja e rrjetit të ujësjellësit është varur vetëm nga vullneti i qeverisjes komunale. Tentativa për të shtrirë ujësjellësit në fshatin Suhodoll ka ngjallur reagime të shumta tek serbët, me ç’rast KFOR-i ka ndërprerë punimet për “shkaqe sigurie”. Kryetari i komunës ka dështuar që të gjejë një zgjidhje për këtë problem. Një problem i tillë ka ndodhur edhe me tri fshatrat veriore Vinarc, Gushavc dhe Vidimriq.</p>
<p>KEK-u të investojë në mirëmbajtjen e rrjetit elektrik</p>	<p>Në komunën e Mitrovicës ende ka probleme me rrjetin e rrymës dhe ka pengesa të shumta edhe në kohën kur ka rrymë nga KEK-u.</p>
<p>Pjesëtarët e KFOR-it dhe Policisë së Kosovës të mundësojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve në të dy anët e qytetit si dhe qytetarët serbë të mund t’i vizitojnë varrezat e të afërmeve të tyre në jug, kurse shqiptarët të kenë mundësi ti vizitojnë ato në veri.</p>	<p>Qytetarët shqiptarë nuk kanë mundur që në mënyrë të organizuar të vizitojnë varrezat në veri, kurse qytetarët serbë me përkrahjen e Bajram Rexhepit kanë vizituar varrezat në jug, ku ka marrë pjesë edhe vetë kryetari Rexhepi.</p>
<p>Kompensimi i qirave për personat e zhvendosur nga veriu në jug të Mitrovicës;</p>	<p>Qeveria e Kosovës me një vendim të muajit shkurt ka ndarë 360,000 € për pagesën e qirasë familjeve të zhvendosura nga veriu i Mitrovicës. Këto mjete mund të bëjnë pagesën për 300 familje për një vit. Kuvendi Komunal ka shpallur konkursin për përzgjedhjen e familjeve më në nevojë, pasi që nuk do të mund të përfitojnë të gjithë, ngase nga veriu janë larguar diçka më</p>

shumë se 1,540 familje që nga viti 1999. Vendimi i Qeverisë është ndryshuar më vonë pasi që Komuna ka ulur vlerën e kompensimit të qirasë nga 100 € në muaj në 70 €, me qëllim që të rritet numri i familjeve që mund të përfitojnë nga kjo ndihmë. Kompensimi do të bëhet vetëm për vitin 2009. Komuna e Mitrovicës si menaxhuese me këtë projekt, ka rritur numrin e familjeve përfituese dhe ka ulur shumën për kompensim. Konkursi për familjet përfituese ka qëndruar i hapur për kohë të gjatë.

## Zgjedhjet lokale në Mitrovicë

Që nga viti 2000, kur për herë të parë u mbajtën zgjedhjet lokale në Kosovë, e deri më tani, në tri palë zgjedhje komunale në Mitrovicë kanë konkurruar 38 subjekte politike. Por, vetëm shtatë parti politike kanë arritur që të fitojnë vota të mjaftueshme që të mund të zënë ulëse në Kuvendin Komunal prej 41 anëtarësh. Në dy palë zgjedhjet e para lokale, LDK doli fituese e zgjedhjeve duke qeverisur e vetme komunën. Në zgjedhjet e nëntorit 2007, PDK doli fituese, edhe pse mori 2,273 vota më pak se sa në vitin 2002, por arriti ta mbajë numrin e njëjtë të ulëseve në KK falë ndarjes së LDK-së.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Mitrovicës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	7784	11	10562	15	8289	15
LDK	21785	29	16516	23	4829	9
AAK	996	1	1763	2	1118	2
LDD	-	-	-	-	1789	3
AKR	-	-	-	-	4859	9
PD	-	-	391	1	352	1
ORA	-	-	-	-	1038	2

Numri në rënie i votave në përgjithësi ka të bëjë edhe me trendin në rënie të pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhjet në Kosovë. Në zgjedhjet e para lokale në Komunën e Mitrovicës, pjesëmarrja në votime ishte në masën 75.2%. në zgjedhjet e dyta lokale, kjo shifër ra në 48.7%, kurse në zgjedhjet e fundit lokale rënia ishte edhe më e madhe dhe vetëm 33.8% e votuesve me të drejtë vote dolën në votime. Edhe pse në zgjedhjet e dyta lokale, serbët lokal ishin pajtuar që të marrin pjesë në zgjedhje, serbët lokal të Komunës së Mitrovicës asnjëherë nuk ju kanë përgjigjur thirrjes për dalje në zgjedhje. Në zgjedhjet e ardhshme të nëntorit 2009 në Komunën e Mitrovicës të drejtë vote kanë 83,310 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Mitrovicë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
<b>Votues me të drejtë vote</b>	<b>44802</b>	<b>65207</b>	<b>67442</b>
<b>Pjesëmarrja në votime</b>	<b>33691</b>	<b>31344</b>	<b>22834</b>
<b>Përqindja e daljes në votime</b>	<b>75.2%</b>	<b>48.07%</b>	<b>33.8%</b>

## Buxheti i Komunës

Në përgjithësi, buxheti i komunës së Mitrovicës ka pasur një trend stabil të rritjes që nga viti 2003, përveç në vitin 2007 kur ka shënuar rënie prej rreth 5% në krahasim me vitin paraprak (2006). Paralelisht me rritjen e buxhetit të përgjithshëm ka ecur edhe trendi i rritjes së rrogave dhe mëditjeve, të cilat gjithashtu përbëjnë më shumë se gjysmën e buxhetit të kësaj komune. Për më tepër, edhe në vitin 2007 kur ka pasur rënie të buxhetit të përgjithshëm, trendi i rrogave dhe mëditjeve ka vazhduar rritjen, ndërsa shkurtime të këtyre vit janë bërë kryesisht në mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione dhe transfere.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	6,788,879 ▲	1,049,674 ▼	371,222 ▲	211,054 ▲	3,104,149 ▲	-	11,524,978 ▲
2008	5,859,956 ▲	1,151,424 ▲	349,500 ▲	153,300 ■	1,794,369 ▼	-	9,308,549 ▲
2007	5,652,309 ▲	840,731 ▼	286,480 ▼	153,300 ▼	1,892,205 ▲	-	8,825,025 ▼
2006	5,634,826 ▲	1,222,279 ▲	376,500 ▲	230,000 ▲	1,798,391 ▼	-	9,261,996 ▲
2005	5,353,171 ▲	1,068,756 ▼	329,123 ■	87,217 ■	2,347,092 ▲	-	9,185,359 ▲
2004	5,345,317 ▲	1,842,398 ▲	-	-	1,429,965 ▲	44,146 ■	8,661,826 ▲
2003	4,217,867 ■	1,615,429 ■	-	-	1,282,916 ■	44,146 ■	7,160,358 ■

Aktualisht, buxheti i komunës së Mitrovicës për vitin 2009 numëron 11,5 milion Euro, prej të cilave vetëm 11.5% janë të hyra vetanake të kësaj komune. Edhe në vitin 2009, më shumë se gjysma e buxhetit të kësaj komune është e planifikuar të shpenzohet në rroga dhe mëditje.

## Investimet kapitale

Në anën tjetër, sa i përket shpenzimeve kapitale të planifikuara, ato kryesisht kanë shënuar ngritje stabile nga viti në vit, përveç në vitin 2006 kur ka pasur një rënie prej rreth 24% në krahasim me vitin paraprak, si dhe në vitin 2008 kur ka pasur rënie të ndjeshme në krahasim me vitin paraprak. Në vitin 2009, mjetet e planifikuara për shpenzime kapitale në komunën e Mitrovicës kanë qenë rreth 3,1 milion Euro, që është rreth 73% më shumë se për vitin 2008. Disa nga investimet kapitale më me rëndësi që janë përfunduar në këto dy vitet e fundit me financim komunal janë:



Tab.5.: Investimet kapitale në Mitrovicë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e investuar
2008	Asfaltimi i rrugës Ahmet Delia	€50,000
2008	Ndërtimi i rrugës Mehmet Aqif Ersoi	€50,573
2008	Ujësullësi Mazhiq	€50,000
2008	Ndërtimi i Sheshit të qytetit	€500,000
2008	Asfaltimi i rrugës së Vidishiqit	€300,000
2009	Ndërtimi i rrugës Cetkoviq - veri	€50,000
2009	Asfaltimi i rrugës Vidishiq	€143,299
2009	Ndërtimi i rrugës në lagjen "2 Korriku"	€45,000
2009	Ndërtimi i banesës sociale - Veri	€389,953

Kuvendi Komunal i Mitrovicës ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, Komuna e Mitrovicës do të ketë në dispozicion 9,741,189 € për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Mitrovicës për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth **12.8 milion €** për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Mitrovicës 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	12,682,551	12,747,720	13,209,756
Të hyrat vetanake në €	1,641,806	1,693,927	1,742,790
Investimet kapitale në €	3,801,633	2,781,673	3,159,883

## Administrata komunale

Në sektorët publik komunal (arsim, shëndetësi dhe administratë) në vitin 2009 janë të punësuar 2,399 persona. Ky numër është rritur në krahasim me vitin e kaluar. Numri i punonjësve në të gjithë këta sektorë komunal ka qenë pothuajse i njëjtë që nga viti 2003.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Mitrovicës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	2399 ▲
2008	2369 ▲
2007	2334 ▼
2006	2378 ▲
2005	2327 ▼
2004	2398 ▲
2003	2300 ■

Në administratën komunale të Mitrovicës janë të punësuar 248 punonjës. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.10/46 të datës 3 dhjetor 2008, administrata

komunale e e kësaj komune nuk mund të ketë më shumë se 200 të punësuar (1 shërbyes civil për 620 banorë). Rendi dhe rregulli në administratën komunale të kësaj komune nuk është në nivel të kënaqshëm. Edhe pse ka një numër të madh të punonjësve tepër, dhe komuna e Mitrovicës duhet që të largoj 48 punonjës, përsëri qytetarët presin në radhë të gjata për marrjen e dokumenteve tyre personale. Kjo për faktin se ky numër i madh i punonjësish nuk është i sistemuar në vende të duhura të punës por ka sektorë që janë të mbingarkuar me staf, kurse ka sektorë tjerë që kanë mungesë të stafit. Mos efikasitetin e administratës komunale e dëshmojnë edhe raportet periodike të MAPL. Sipas kësaj ministria, në pjesën e parë të vitit 2009, Komuna e Mitrovicës ka pranuar 3,915 kërkesa, por ka arritë të zgjidh vetëm 23.09% prej tyre.

## Komuna e Mitrovicës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Komuna e Mitrovicës në masë të madhe ka respektuar dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale. Kuvendi Komunal i Mitrovicës është Kuvendi me numrin më të madh të mbledhjeve të mbajtura gjatë vitit 2008. Në vitin 2008 KK i Mitrovicës ka mbajtur 14 mbledhje, katër më shumë se që kërkohen në Ligjin për vetëqeverisje lokale (sipas ligjit, çdo Kuvend Komunal duhet të mbaj së paku 10 mbledhje të rregullta). Kurse në gjashtëmujorin e parë të 2009 KK i Mitrovicës ka mbajtur katër mbledhje. Komiteti për Politikë dhe Financa, si komiteti kryesor komunal i cili përgatit rendin e ditës për KK, gjatë 2008 ka mbajtur 11 takime; kurse në gjashtëmujorin e parë të 2009 ka mbajtur 6 mbledhje. Përveç KPF-së, Kuvendi Komunal i Mitrovicës ka të themeluara edhe 6 komitete tjera të cilat nuk janë edhe aq aktive. Kryetari i Komunës së Mitrovicës gjatë vitit 2008 ka mbajtur dy tubime publike, aq sa parashihen edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Kurse në vitin 2009, në gjashtëmujorin e parë, kjo komunë nuk ka mbajtur asnjë tubim publik; meqë rast ka shkëlur ligjin, sipas të cilit komunat duhet të mbajnë së paku dy tubime publike me qytetarë, njërin prej tyre në gjashtëmujorin e parë.

Gjatë vitit 2008 në Komunën e Mitrovicës janë parashtruar 7 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, kurse në pjesën e parë të 2009 janë parashtruar 20 kërkesa dhe një peticion i qytetarëve.

Gjatë vitit 2008 Kryetari i Komunës së Mitrovicës ka raportuar dy herë para Kuvendit komunal, aq sa kërkohet edhe me ligj.

Komuna e Mitrovicës ka edhe uebfaqen zyrtare. Ueb faqja është e mirëmbajtur në baza të rregullta kohore. Në përgjithësi, ueb faqja si pikë të fortë ka azhurnimin dhe mbushjen me informata të vazhdueshme edhe për lajmet dhe aktivitetet e fundit që ndodhin në komunën e Mitrovicës. Mirëpo, nga tabela më poshtë shihet që në uebfaqen e KK Mitrovicë ka zbrazëti të konsiderueshme në lidhje me shërbimet/projektet komunale në veçanti.

Tab.6. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës  
([www.mitrovica-komuna.org](http://www.mitrovica-komuna.org))

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave <sup>1</sup>
Ballina	3
Organizimi komunal	4.67
Shërbimet komunale	1.8
Info rreth qytetit	4.25
Projektet komunale	3.5
Lajme& lajmërimë	3.67
Harta e faqes	1
Kontakt	2
Gjuhët	4
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	4
Baza Ligjore	4
Mesatarja totale	3.07
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	13

## Gjendja në arsim

Në Komunën e Mitrovicës sistemi arsimor zhvillohet që nga niveli parafillor e deri tek ai universitar. Në këtë komunë funksionon një çerdhe me 304 nxënës; 37 shkolla fillore (me paralele të ndara) dhe 5 shkolla të mesme. Në arsimin fillor dhe të mesëm i zhvillojnë mësimet 19,408 nxënës. Për shkak të industrisë së zhvilluar dhe pasurive nëntokësore, në këtë komunë ishte themeluar dhe ende funksionin Fakulteti Xehtar-Metalurgjik dhe ai i Shkencave Aplikative, pjesë e Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2008 me mjete të MASHT (654,613 €) ka filluar ndërtimi i një objekti të shkollës së mesme në Mitrovicë. Po me mjete të MASHT, në Shipol të Mitrovicës ka filluar ndërtimi i objektit të shkollës fillore (700,000 €); dhe objekti i shkollës fillore në Zhabar (200,000 €) me bashkëfinancim të komunës dhe ministrisë. Punimet në këto shkolla kanë vazhduar edhe në 2009. USAID ka ndarë 145.000 € për meremetimin e objektit të shkollës fillore "Ismail Qemali". Në shkollën "Aziz Sylejmani" punohet në tri ndërrime për shkak se nxënësit e kësaj shkolle nuk mund ti zhvillojnë mësimet në pjesën veriore të qytetit aty ku edhe është i vendosur objekti i shkollës.

## Gjendja në shëndetësi

Në komunën e Mitrovicës ekziston një QKMF, 8 QMF dhe 14 ambulanca. Në Mitrovicë punojnë 273 punëtor shëndetësor, prej tyre 45 mjek. Përndryshe komuna e Mitrovicës e ka edhe spitalin e qytetit por spitali gjendet në pjesën veriore të qytetit dhe nuk mund të shfrytëzohet nga banorët shqiptarë. Në pjesën jugore të qytetit është improvizuar një spital i cili nuk i plotëson kushtet elementare për punë si dhe nuk ofron shërbime të mjaftueshme. Në këtë spital ofrohen vetëm shërbimet e mjekësisë së përgjithshme, ndërsa punon vetëm një gjinekolog deri në orën dy pasdite. Për çdo shërbim tjetër shëndetësor qytetarët e Mitrovicës duhet ti drejtohen Vushtrrisë apo Prishtinës. Spitali i qytetit i cili gjendet në pjesën veriore që

<sup>1</sup> (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

kontrollohet nga serbët është i pajisur mirë dhe se stafi mjekësor paguhet nga fondi serb për Kosovën.

Ekziston një projekt i ISE për ndërtimin e një spitali në pjesën jugore të Mitrovicës, mirëpo ky projekt po zvarritet për shkak të situatës së ndjeshme të sigurisë në qytet dhe hezitimit të donatorëve.

90,000 banorët e pjesës jugore të Mitrovicës kanë në përdorim vetëm një autoambulancë të spitalit regional, kurse auto ambulancat e QKMF nuk janë funksionale. Zyrtarët komunal shprehen se për vitin 2008 nuk ka pas mjete për të blerë ndonjë auto ambulancë. Në vitin 2009, Komuna ka ndarë 50,000 € për blerjen e një autoambulance dhe 47,779 € për ndërtimin e QMF-së në fshatin Rasha. Por asnjëri nga këto dy projekte nuk ka filluar së zbatuari në nëntëmujorin e parë të 2009.

## Shoqëria civile

Në komunën e Mitrovicës ekzistojnë një numër i madh i organizatave joqeveritare. Për shkak të situatës konfliktuozë ndëretnike në këtë komunë, shumica e organizatave të regjistruara fokusin kryesor kanë marrëdhëniet ndëretnike. Organizata më aktive në këtë komunë është CBM (Community Building Mitrovica). CBM mision të saj ka identifikimin dhe avancimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve për integrimin e komuniteteve përmes fasilimitit të dialogut ndëretnik dhe avokimit si dhe ndihmon fuqizimin e shoqërisë civile përball institucioneve llogaridhënëse. CBM gjithashtu ka projekte edhe për rininë dhe gratë. Drejtuesja e organizatës CBM para disa viteve është shpërblyer edhe me çmimin për “Gratë e Guximshme” që i është ndarë nga Departamenti Amerikan i Shtetit, për punën e saj në drejtim të pajtimit të komuniteteve. Përpos CBM, organizata tjera aktive janë edhe “Pëllumbat e Paqes”, “Me dorë në zemër”, “Yjet e Galaktikës” etj.

## Mediat lokale

Komuna e Mitrovicës ka një televizion lokal TV Mitrovica, e cila transmetohet edhe në rrjetin kabllor në tërë Kosovën, si dhe dy radio lokale Radio Mitrovica dhe Radio Ylberi. Në të kaluarën komuna e Mitrovicës ka pasur aktive edhe Radio Globin por për shkak të kushteve financiare kjo radio është shuar. Komuna e Mitrovicës ka edhe radio të komuniteteve tjera- sidomos atë serbe siç janë Radio Contact Plus, Radio Kiss, etj. Këto medime kanë program të rregullt informativ përmes së cilëve informojnë qytetarët për jetën publike komunale, aktivitetet e qeverisë lokale, pasqyrim të punimeve të trupave komunale. Drejtuesi i TV dhe Radio Mitrovica njëkohësisht është edhe kandidat për kryetar komune, për dy mandate radhazi; ndërsa pronari i Radio Ylberit mban një post ekzekutiv në Komunën e Mitrovicës. Qytetarët shprehen se i dëgjojnë këto medime për programet e tyre argëtuese, por jo edhe për programet informative. Qytetarët shprehen se për shkak të specifikave që ka kjo komunë, edhe medimet kombëtare i japin një hapësirë të konsiderueshme Komunës së Mitrovicës. Edhe gazetat ditore kanë korrespondentët e tyre të cilët raportojnë për aktivitetet e pushtetit lokal dhe ndodhitë në këtë komunë. Mirëpo, dy nga korrespondentët e gazetave ditore (ai i “Lajm” dhe “Epoka e Re”), janë njëkohësisht edhe punonjës në zyrën për informim në komunë dhe raportimi i tyre për gazetat në të cilat punojnë është zakonisht në formë të njoftimit zyrtar që e lëshon

komuna. Qytetarët vlerësojnë punën e dy korrespondentëve të “Kohës Ditore” dhe të “KosovaLive”.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Mitrovicës

Në komunën e Mitrovicës, si shumë çka tjetër, edhe stacionet policore janë të ndara: stacioni policor veri dhe ai në jug. Gjatë periudhës një vjeçare, janar-dhjetor 2008, në pjesën jugore të Mitrovicës janë regjistruar 3,507 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në 38 fusha të ndryshme të shkeljes së rendit dhe ligjit. Tabela më poshtë tregon për shkeljet më të mëdha në numër dhe më të zakonshmet që kanë ndodhur në pjesën jugore të Mitrovicës të cilat janë regjistruar nga Stacioni Jugor i Policisë së Kosovës.

Tab.11. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Mitrovicë (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	324
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	138
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	38
Vjedhje e pyjeve	11
Incidente lidhur me pronën	71
Vjedhje	777
Abuzime seksuale	12
Shkaktim të dëmtimeve trupore	138
Kërcënime	75
Mashtrime	21
Vrasje	17
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	1

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përllogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje të UNMIK-ut, Komuna e Mitrovicës ka miratuar Rregulloren Komunale për Tatim në Pronë për vitin 2009, me të cilën janë caktuar zonat, norma tatimore dhe vlera e pronës në treg.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Mitrovicës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			

	Norma tatimore				
	0.09%	0.09%	0.12%	0.17%	0.09%
I	450 €*	400 €	700 €	350 €	150 €
II	350 €	350 €	500 €	300 €	150 €
III	300 €	300 €	350 €	250 €	150 €
IV	200 €	200 €	250 €	200 €	150 €
V	-	100 €	150 €	150 €	150 €

\* Vlera e tregut për metër katror.

## Kostoja për biznese

Në Komunën e Mitrovicës operojnë rreth 3,300 biznese. Leja e punës për funksionimin e një biznesi merret në komunë e cila në bazë të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, ka caktuar shumën për regjistrimin e çdo biznesi. Tabela më poshtë pasyron disa nga bizneset kryesore dhe shumat vjetore që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	600
Kompanitë e sigurimit	600
PTK komunikimi dhe distribucioni	600
Agjensionet turistike	350
Hotelet	600
Motelet	450
Supermarketet-Hipermarketet	350
Vetëshërbimet – Minimarketet	250
Kafeteritë	250
Restorant	350
Shitoret	150
Shtëpitë e mallrave	600
Barnatoret	350
Ndërmarrjet grafiko-botuese	450
Gurthyesit	600
Autoshkollat	250
Auto-taxi	60
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	40
Ndërmarrjet (ndërtimore, industriale, etj.)	350
Pompat e benzinës	450
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	150-250